

Sheherzada Murati, PhD¹

UDC:
342.722(4-672 EY)

**PARIMI I MOS-DISKRIMINIMIT SI PJESE E UNIONIT
EVROPIAN**

**ПРИНЦИПОТ НА НЕ-ДИСКРИМИНАЦИЈА КАКО ДЕЛ
ОД ЕВРОПСКАТА УНИЈА**

**PRINCIPLE OF NON-DISCRIMINATION AS PART OF THE
EUROPEAN UNION**

Abstract

The work at hand is intended to provide an overview about the process of adoption and implementation of laws who occupy senior positions in the OSCE agenda, the Council of Europe, the European Union as well as governmental and non-governmental organizations. Human rights and fundamental freedoms traditionally has been treated as a matter of domestic jurisdiction of states and therefore their regulation was by law, the Declaration or the Constitution. Sometimes it thought that human rights (or at least some of them), are so important that counted as part of the „natural law“ but most of these rights are considered an integral part of the treaties. Also the paper at hand will examine the institutional framework for the implementation of protection against discrimination in the Republic of Macedonia, and the same will provide a critical overview of legal changes in the Macedonian national legislation against European legislation and to reconsider all institutions and bodies who are authorized to accept and act on

¹ Universiteti i Tetovës, Fakulteti Ekonomik, Tetovë, Republika e Maqedonisë,
sheherzada.murati@unite.edu.mk

individual complaints. The work summarizes democratic values, the change of legislation, national identity and the security of the country and the situation with regard to anti-discrimination policies and their implementation.

Keywords: Constitution, Law on prohibition of discrimination and protection, European Union, Council of Europe, the OSCE, the Ombudsman.

HYRJE

Sistemi evropian i të drejtave të njeriut është një nga sistemet rajonale më mirë të punuar. Ai është zhvilluar si kundërpërgjigje të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut gjatë Luftës së Dytë Botërore. Sistemi rajonal për të drejtat e njeriut, zakonisht siguron një standard më të lartë të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe njëkohësisht realizimin e tyre. Përparësia e këtij sistemi qëndron në kapacitetin e tij për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut në mënyrë më efektive. Sistemi evropian për të drejtat e njeriut ka tri nivele dhe atë:

- Këshilli i Evropës 45 anëtarë
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë 55 anëtarë
- Bashkimi Evropian 28 anëtarë

Gjykatat mund të sjellin vendime dhe dëmshpërblime ligjërish të detyrueshme. Gjithashtu, rekomandimet e Komisioneve për të drejtat e njeriut zakonisht trajtohen seriozisht dhe në mënyrë më transparente nga ana e shteteve. Këto vendime nuk rezultojnë vetëm me ndërtimin e „praktikës gjyqësore“ në lidhje me interpretimin dhe sqarimin e dispozitave dhe instrumenteve për të drejtat e njeriut, por edhe me ndryshimin e së drejtës nacionale, me qëllim të përputhjes me detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.² Njëkohësisht, të drejtat e njeriut, sundimi i së drejtës dhe demokracia pluraliste, paraqesin themelet e sistemit juridik evropian.

Integrimi i Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian filloi me pavarësinë e sajë në vitin 1991, kur anëtarësimi në UE me konsensus u deklarua si qëllim strategjik i R. Maqedonisë, prandaj në vazhdimësi

² „Разбирање на човековите права“ (Doracak për edukimin nga lëmia e të drejtave të njeriut), Grad: Qendra Evropiane për trajnim dhe hulumtim të të drejtave të njeriut dhe demokraci – ETC, 2006, f.38

ndërmerren hapa politike për zhvillimin e marrëdhënive të mira dhe diplomatike midis Republikës së Maqedonisë dhe Unionit Evropian.

Vendet e Evropës Juglindore, por edhe Republika e Maqedonisë, përveç Paktit për stabilizim dhe Marrëveshjes për asocim, duhet t'i plotësojnë edhe Kriteret e Kopenhagës³ të miratuara me Traktatin e Mاستrihtit në vitin 1993.

Që nga viti 1997, Komisioni Evropian jep raporte vjetore për R. Maqedonisë në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterëve të Kopenhagës. Për këtë qëllim Komisioni ka zhvilluar një metodologji në kontekst me Agjendën 2000. Në tetor të vitit 2009, Komisioni ka dhënë rekomandim për hapjen e negociatave për pranim. Që atëherë UE u jep mbështetje dhe udhëzime të vazhdueshme autoriteteve kombëtare mbi reformat prioritare nëpërmjet Partneritetit për anëtarësim dhe raportet e rregullta për progresin e vendit.

Respektimi i të drejtave të njeriut, avancimi i vlerave demokratike, ballafaqimi me pabarazitë e përhershme dhe me fenomenin e diskriminimit, e gjithë kjo mund të bëhet vetëm me zbatimin e legjislacionit horizontal, me qëllim që të arrihet avancimi i mëtutjeshëm i institucioneve nga ana e organeve për zbatimin e ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, duke ndërmarrë iniciativa për të rritur ndërgjegjësimin, me qëllim që të sigurohen segmente të ndryshme, që publiku të ketë një kuptim më të qartë rreth këtij legjislacioni, zbatimin e tij, dhe avancimin drejt kyçjes së qytetarëve në konsultimet dhe sjelljen e vendimeve në të gjitha nivelet, veçanërisht në ato politika dhe pyetje të cilat drejtpërsëdrejti ndikojnë tek ato.

1. KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT- NENI 14

Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut paraqet një nga „sistemet rajonale“ më efektive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat pretendojnë të mbrojnë një gamë më të gjerë të të drejtave civile dhe politike, në formë të marrëveshjes, e cila është e plotfuqishme nga Palët e larta kontraktuese, dhe përmes krijimit të një sistemi për monitorimin e zbatimit të të drejtave në planin nacional.

³ Limani, M. *Integrime ekonomike Evropiane*, Prishtinë, 2008, f.89

Për herë të parë, shtetet sovrane pranuan detyrime juridike për sigurimin klasik të të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët nën juridiksionin e tyre, dhe u mundësuan të gjithë individëve, duke i kycur edhe qytetarët e vetë, që të parashtrajnë ankesa kundër tyre⁴, e të cilët çojnë deri në aktgjykim juridikisht të detyrueshëm nga Gjykata ndërkombëtare, nëse ajo vërteton se shtetet bartin fajësinë për shkelje të të drejtave.

Nuk është kontestuese se Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut është nën ndikimin e Deklaratës për të drejtat e njeriut nga OKB⁵, e cila del nga Preambula, ku qartë thekson se Qeveritë janë të vendosura në ndërmarrjen e hapave të para për fuqizim dhe sigurim kolektiv të të drejtave të garantuara në Deklaratën Universale.

Në Preambulën e Konventës nuk ka thirrje në *parimin e mosdiskriminimit*, as nuk ekziston neni i posaçëm për barazi. Në Konventë nuk ofrohet asnjë lloj definimi të fjalës „diskriminim“, edhe pse definime të llojllojshme gjenden në Konventat bashkëkohore. Nga kjo, *diskriminimi për punësim dhe kryerje të veprimtarive* definohet *çdo diferencim, përjashtim ose preferencë e cila e ka efektin e anulimit ose marrjes së barazisë në lidhje me fitimin e mundësive ose trajtimin gjatë punësimit ose kryerjes së veprimtarisë*.⁶

Ky definicion është pranuar nga një numër i madh i shteteve që janë nënshkruese të Konventës për të drejtat e njeriut, që patjetër duhet të jetë i cilësisë bindëse të nenit 14 të Konventës.

Duke e marrë parasysh supozimin se *diskriminimi* dhe *mosdiskriminimi* janë terme të ndërlidhura në mes veti, kur bëhet fjalë për jofavorshmërinë, barazinë ose përparësinë,⁷ fjala është për trajtimin e një personi apo grupi, ose për mënyrën e sjelljes ndaj personave të tjerë

⁴ Personat fizikë dhe juridikë mund të parashtrajnë ankesa kundër shteteve

⁵ *Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut* e miratuar më 4 nëntor 1950, ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953

⁶ Formulimi i mësipërm është i marrë nga *Konventa për diskriminim racor nga Kombet e Bashkuara*,⁶ neni 1. Shtesë këtu, në Konventën e UNESCO-s për diskriminim në arsim (1960), neni 1, diskriminimi sqarohet si: Çdo diferencim, përjashtim, kufizim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, bindje politike ose bindje të tjera, prejardhje nacionale ose sociale, gjendja ekonomike ose lindja, që kanë për qëllim anulimin ose ndërprerje të barazisë.

Rezoluta e Asamblesë Gjenerale, 2106:XX (19 janar, 1996), ish-deklarata në Rezolutën e Asamblesë Gjenerale 1904:XVIII (26 shkurt, 1963).

⁷ Me fjalën "pafavorshëm" duhet të kuptohet si diçka që përfshinë përjashtimi, kufizim, varfëri, mohim, ndërsa termi "përparësi" do të thotë respekt, privilegj dhe përfitim.

ose grupeve. Për këtë arsye, fjala „barazi“ nënkupton se e drejta e fituar në atë mënyrë, duhet patjetër të jetë e barabartë me të drejtën të cilën e gëzon ndonjë person tjetër. E drejta e cila është fituar pa kushtëzim dhe e pavarur nga persona tjerë, nuk mund me saktësi të përshkruhet si „e drejtë e barabartë“.

Parimi i barazisë nuk do të thotë barazi absolute, por e njëj barazinë relative, gjegjësisht trajtim i ndryshëm në përputhje me rrethanat specifike individuale.

Trajtimi i ndryshëm nuk mundet të tregohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ai kërkon racionalitetin apo duhet të jetë në përputhje me ligjin, si në qëndrimin ndaj minoriteteve, po ashtu edhe në qëndrimin ndaj barazisë gjinore, etj. Në këto raste, dallimi ka për qëllim mbrojtjen e të prekurve, e cila nuk është e dëmshme dhe kundër vullnetit të tyre.⁸

Prandaj **neni 14**, qëndron vetëm në Konventë, i plotësuar me thirrjen e të njëjtit në nenin 16, në të cilin thuhet se: asgjë në nenet 19 (2), 11 (3) dhe 14 nuk duhet të konsiderohet si një pengesë për Palët e larta kontraktuese që të kufizojnë veprimtarinë politike të të huajve.⁹

Me fjalë të tjera, neni 14 nuk përmban një dispozitë të përgjithshme e cila ndalon çdo formë të diskriminimit. Ajo vlen për diskriminimin e atyre të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë. Megjithatë, Komisioni dhe Gjykata vendosën të deklarojnë se nëse konsiderohet se shteti i ka përmbushur detyrimet e tij në lidhje me një nga të drejtat e pavarura, kur bëhet fjalë për një rast të caktuar, gjithashtu është i mundshëm përfundimi se të njëjtat të drejta janë të shkelura në lidhje me nenin 14.¹⁰ Çdo qëndrim ndryshe ndaj individëve në situata të ngjashme nga ana e shtetit, sipas nenit 14 të Konventës duhet të bazohet në justifikim objektiv dhe racional.

⁸ Fawcett, J.E.S., *The Application of the European Convention on Human Rights*, Clarendon, 1987, pp.294-306.

⁹ Андреевска, Е. *Националните малцинства на Балканот согласно на системот за заштита на човековите и малцински права на ООН и Советот на Европа*, Магор, Скопје, стр.380.

¹⁰ A Short Guide to the European Convention on Human Rights, pp.113

2. PROTOKOLLI 12 I KONVENTËS EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij Protokollit duke marrë parasysh parimin themelor, sipas të cilit *të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë*, të vendosur për të ndërmarrë hapa të mëtijshëm nëpërmjet fuqizimit kolektiv për ndalim të përgjithshëm të diskriminimit nëpërmjet *Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore*,¹¹ duke pohuar se parimi i mosdiskriminimit nuk i ndalon shtetet anëtare të marrin masa për të promovuar barazi të plotë dhe efektive, me kusht që të ekzistojë një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm për ato masa.

Protokollit 12 i KEDNJ-së, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2005, ky protokoll zgjeroi fushëveprimin e ndalimit të diskriminimit, në mënyrë që të mbulojë të gjitha të drejtat e garantuara në nivel kombëtar, edhe kur ata nuk janë të mbuluara në kornizat e të drejtave të garantuara nga KEDNJ. Megjithatë, Protokollit është ratifikuar nga ana e 17 shteteve nga gjithsej 47 shtete të Këshillit të Evropës, gjashtë prej të cilave janë shtete anëtare të Unionit Evropian. Kjo do të thotë se në mesin e shteteve anëtare të UE-së ka nivele të ndryshme të obligimeve që dalin nga e drejta evropiane për mosdiskriminimin.

Neni 1 i Protokollit 12, parashikon një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit, gjegjësisht *„gëzimi i të gjithë të drejtave të përcaktuara me ligj, të cilat duhet të mbrohen nga diskriminimi gjinor, sipas ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjes politike, origjinës kombëtare dhe sociale, përkatësia, pasuria (prona), lindja apo ndonjë status tjetër, „dhe“ askush nuk duhet të diskriminohet nga autoritetet publike“*. Protokollit 12 ka për qëllim të zgjerojë ndalimin e diskriminimit, duke i përfshirë të gjitha të drejtat dhe liritë e përcaktuara në KEDNJ dhe me ligjin vendas. Po ashtu, Protokollit 12, ndalon diskriminimin në lidhje me *„gëzimin e ndonjë të drejte të përcaktuar me ligj“*, dhe nga kjo del se ky protokoll ka një peshë dhe rëndësi më të madhe se sa neni 14, i cili vlen vetëm për të drejtat e garantuara nga KEDNJ.

Protokollit 12 nuk ka për qëllim të zëvendësojë Nenin 14, por në një mënyrë për të plotësuar atë, duke e pranuar praktikën gjyqësore të

¹¹ E nënshkruajtur në Romë më 4 nëntor 1950

deritanishme në lidhje me ndalimin e diskriminimit. Gjithashtu, përcaktton se rëndësia e ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit do të jetë identike me nenin 14 në lidhje me bazat diskriminuese dhe llojet e nënlojet e të drejtave dhe lirive themelore. Sipas, komenteve në lidhje me vlerësimin e rëndësisë së këtyre koncepteve, në raportin e publikuar të Këshillit të Evropës, dispozitat në vijim vlejné për diskriminimin:

- Në gëzimin e çdo të drejte, të cilën ligji kombëtar në mënyrë konkrete ia jep individit;

- Në gëzimin e së drejtës e cila mund të nxirret nga obligimi i qartë i një autoriteti publik e nënshkruar me legjislacionin kombëtar, gjegjësisht, në përputhje me ligjet kombëtare, ndonjë organ publik është i detyruar që të veprojë në mënyrë të caktuar;

- Nga ana e ndonjë organi publik, për kryerjen e kompetencave diskriminuese (për shembull, dhënien e ndonjë subvencioni);

- Nëpërmjet ndonjë mënyre tjetër ose lëshim i bërë nga ana e një organi publik;

- Nëpërmjet ndonjë akti tjetër ose lëshim i bërë nga ana një organi publik (p.sh. sjellja e një anëtari të policisë në kontrollimin e trazirave).

Protokolli kryesisht mbron individët nga diskriminimi që ua bën shteti, por kjo vlen edhe për marrëdhëniet ndërmjet personave juridik, që mendohet se zakonisht rregullohen nga shteti, *“për shembull, refuzim i vullnetshëm për qasje në punë, qasje në restorante, apo për shërbimet të cilat persona privat i mundësojnë për publikun, siç janë kujdesi shëndetësor apo shërbimet komunale si furnizimi me ujë apo energji elektrike“*.

Në përgjithësi, Protokolli 12 ndalon diskriminimin jashtë konteksteve personale, ku individët kryejné funksione që i vënë ato në një pozitë për të vendosur për mënyrën se si ofrohen shërbimet publike në dispozicion. Me fjalë të tjera mund të themi se Shtetet janë të detyruara të sigurojnë kushte të barabarta që ***të gjithë të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre.***

3. UNIONI EVROPIAN DHE MEKANIZMAT PËR MONITORIMIN DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Unioni Evropian është një bashkim politik, ekonomik dhe monetar, që u krijua me Traktatin e Parisit në vitin 1954.¹² Të drejtat e njeriut për UE kanë më tepër rëndësi, si në marrëdhëniet midis shteteve anëtare, po ashtu edhe në marrëdhëniet e tij me vendet jo anëtare, e veçanti me vendet kandidatë për anëtarësim në UE.¹³

Unioni Evropian ka autoritet legjislativ dhe ekzekutiv, përmes të cilit mund të veprojë kundër shteteve anëtare ose subjekteve private, në mënyrë që krijon ndikim në detyrimet e tyre ose të drejtave në lidhje me Konventën.

Juridiksioni i UE është rritur me Traktatin e Mastrohrit (1992), me të cilin të drejtat e njeriut marrin aktualitetin më të madh. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut, jo vetëm që paraqesin parim themelor të UE-së, por bëhen pjesë e së drejtës evropiane, të inkorporuara në mënyrë të qartë në Traktatin e UE-së, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 1993, si qëllim i përbashkët i vendeve anëtare.

Në këtë mënyrë të drejtat e njeriut paraqesin çështje prioritare të politikës së jashtme dhe të brendshme të UE-së. Në pajtim me nenin 2 të Traktatit të UE-së, si objektiva kryesore të unionit janë: forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe interesave të qytetarëve nga shtetet e saj anëtare, mirëmbajtja dhe zhvillimi i Bashkimit, si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Njëkohësisht me Nenin 6 (2) thotë se Bashkimi është i detyruar të respektojë „*liritë themelore të garantuara*

¹² Fillimisht Bashkimi Evropian ishte i përbërë nga gjashtë shtete anëtare: Gjermania, Franca, Italia, Holanda, Luksemburgu dhe Belgjika, më vonë numri i vendeve në familjen evropiane është rritur duke iu bashkuar Britania e Madhe, Greqia, Portugalia, Spanja, Danimarka, Holanda, e në vitin 1995 u bashkua edhe Austria, Finlanda, Suedia, në vitin 2004, u anëtarësuan edhe 10 vende të Evropës Juglindore kurse në vitin 2009 edhe dy vende të tjera: Bullgaria dhe Rumunia.

¹³ Respektimi i të drejtave të njeriut një kohë të gjatë nuk ka pasur lidhje me anëtarësimin, sepse është menduar se vendet anëtare të kësaj organizate në përgjithësi i kanë respektuar të drejtat e njeriut. Ata gjithashtu ishin palë kontraktuese në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa Gjykata Evropiane e Drejtësisë është kujdesur për respektimin e të drejtave të njeriut, njëkohësisht e ka krijuar edhe praktikën gjyqësore për mbrojtjen e tyre.

nga Konventa e Këshillit të Evropës për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut...“¹⁴.

Unioni Evropian angazhimin e tij për të respektuar të drejtat e njeriut, e shpreh në mënyra të ndryshme. Gjegjësisht, u bë rregull, që marrëveshjet e lidhura me vendet e treta të përmbajnë dispozita për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, ndërsa mosrespektimi i tyre është arsye për përjashtim, madje edhe prishjen e marrëveshjes.

Anëtarësimi i shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore në Unionin Evropian kushtëzohet nga Kriteret e Kopenhagës të miratuara më 22 qershor 1993, nga ekzistenca e “*institucioneve stabile që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, respektimin e pakicave dhe mbrojtjen e tyre*”.¹⁵

Unioni Evropian, në marrëveshjet të cilat i nënshkruan me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore ka paraparë mundësinë e pezullimit të të njëjtave, në rast të shkeljes së të drejtave themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtat e pakicave. Në këto rrethana të reja, Unioni Evropian, u përpoq që të krijojë një kornizë me të cilën do të siguronte mbrojtje të plotë për të gjithë, me arsye që të shmang tensionet e mundshme dhe konfliktet në kontinentin evropian, që veçanërisht kanë të bëjnë me pakicat kombëtare dhe me kufijtë. Shtetet anëtare të UE-së konsideronin se nuk ka nevojë për të miratuar një dokument të veçantë që do të rregullonte fushën e të drejtave të njeriut në vetë UE-në, por në fund të vitit 1999 vendosën që të përgatisin Kartën e UE-së për të Drejtat Themelore, e cila u miratua në vitin 2000 dhe u botua nga institucionet e UE-së, Këshillit, Komisionit dhe Parlamentit, në dhjetor të vitit 2000. Karta përfaqon karakterin universal të të drejtave të njeriut, por edhe mbulon të drejtat civile dhe politike, si dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.¹⁶

Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga UE-ja pasqyron faktin, se shumica e organeve dhe institucionet brenda UE-së janë të përfshirë në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Këshilli Evropian, Këshilli dhe Komisioni, janë aktorët kryesorë në ndërtimin e politikave, marrjen e vendimeve dhe zbatimin e tyre. Në të njëjtën kohë, Parlamenti Evropian, Gjykata Evropiane e

¹⁴ Андреевска, Е. *Меѓународно јавно право*, Тетово, 2012, стр.252

¹⁵ Florence Benoit-Rohmer, op.cit., p.34

¹⁶ See European Council Decision on the drawing up a Charter of Fundamental Rights of the European Union, Annex IV of the Conclusions of the Presidency, Cologne European Council.

Drejtësisë dhe Ombusmani Evropian gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si brenda UE-së, po ashtu edhe jashtë saj.

Karta e BE-së për të Drejtat Themelore, pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës (1 dhjetor 2009), u bë pjesë e së drejtës primare të Komunitetit, që do të thotë se mbrojtja e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, janë në nivel më të lartë në UE. Njëkohësisht, parashikon disa të drejta të reja që nuk janë përfshirë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shembull: *e drejta për të dhënat e mbrojtjes në bioetikë, të drejtat e punëtorëve, njohjen e diskriminimit në të gjitha format, etj.* Këto të drejta nuk janë ligjërish të detyrueshme vetëm për Unionin, por edhe për shtetet anëtare të Unionit në zbatimin e së drejtës të Bashkimit, ndërsa Gjykata Evropiane e Drejtësisë, siguron zbatimin e të drejtave të garantuara nga Karta.

3.1. POLITIKA E UNIONIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT

Mbrojtja e të drejtave të njeriut nuk është detyrë bazë e Bashkimit Evropian, por ka prejardhjen nga angazhimi tradicional i përgjegjësisë dhe vetëdijes politike të Unionit Evropian. Në institucionet e Unionit Evropian, në procesin e zgjerimit dhe marrëdhëniet e jashtme të Bashkimit Evropian, respektimi i të drejtave të njeriut, gjithnjë ka qenë me një rëndësi të konsiderueshme. Nga fillimi i viteve të 90-ta Unioni Evropian e përforcon angazhimin e tij ndërkombëtar në ngritjen (promovimin) e mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe demokratizimit, me ndërhyrje të plotë të klauzolës për mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe demokracisë në bashkëpunim me shtete të tjera. Përpjekjet për promovim të të drejtave dhe lirive të njeriut nëpër botë janë vështirësuar për shkak të mungesës së pozicionit ligjor dhe ngel e shënuar me institucionalizim të instrumenteve të jashtme ekonomike dhe politike.¹⁷

Është e qartë se komponenta në procesin e bashkimit të Evropës, mbetet tentimi për sigurimin e mbrojtjes kushtetuese të të drejtave qytetare dhe politike dhe shpesh të të drejtave sociale dhe ekonomike të njeriut. Në konceptin për “Evropën” si një “hapësirë” të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, për qëllim të tij ka standardet Evropiane për të drejtat e

¹⁷ Андреевска, Е. *Политички проблеми за интегрирање во ЕУ, Тетово, 2012,* стр.27

njeriut dhe instrumenteve për respektim të të drejtave dhe lirive kryesore të njeriut.

Hapi më i rëndësishëm, në drejtim të integritit të të drejtave të njeriut në sistemin ligjor të Unionit Evropian, është bërë me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit në vitin 1999, me të cilin është reviduar Traktati i Mاستritit, sikurse në formën ligjore, ashtu edhe në drejtim të konsolidimit të tre shtyllave mbi të cilat mbështeten veprimet e Unionit Evropian. Sa i përket të drejtave të qytetarit, Traktati i ri i Amsterdimit caktoi tre fusha kryesore të funksionimit të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Unioni Evropian obligohet të promovojë kushte të njëjta për punësim për të dy gjinitë (mashkullore e femërore) në të gjitha fushat. Ky Traktat jep përgjigje për nevojat praktike të qytetarëve siç janë: punësimi dhe çështjet sociale, siguria, mjedisi jetësor, shëndetësia dhe të drejtat e konsumatorëve.¹⁸

4. MAQEDONIA NGA ASPEKTI I MONITORIMIT NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJEN E MOSDISKRIMINIMIT

Instrumentet më të rëndësishme të Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut, që lidhen direkt me parandalimin dhe ndalimin e diskriminimit, janë: Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, Protokollu 12 i KEDNJ-së, Karta Sociale Evropiane dhe Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Republika e Maqedonisë si vend kandidat për anëtarësim në UE, është e detyruar të harmonizojë legjislacionin e saj me sistemin ligjor të UE-së i cili parashikon edhe ndalimin e diskriminimit. Gjegjësisht, përgjegjësia për luftimin e diskriminimit (me përjashtim në bazë diskriminuese, sipas seksit/gjinisë), UE-ja i ka fituar në vitin 1999 me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit (neni 13) i cili kaloi në bazën ligjore për miratimin e dy direktivave të mos-diskriminimit: Direktiva 2000 / 43 / EC dhe Direktiva 2000/78 / EC. Përveç këtyre dy direktivave mund të nxirren në pah dhe direktivat e miratuara për ndalimin e diskriminimit gjinor, Direktiva e Këshillit 2004/113 / EC; 2006/54 / EC dhe Karta e të drejtave themelore dhe përpjekjet për miratimin e draftit për Direktivën horizontale për trajtim të barabartë.

¹⁸ Reka, B., Ibrahim, A. *Studime Evropiane Tetovë, 2004*, f.194

Brenda sistemit rajonal për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, e që është në interes edhe për vendin tonë, është sistemi Evropian për mbrojtje në të cilin përfshihet Këshilli i Evropës.

Republika e Maqedonisë si anëtare e plotë e Këshillit të Evropës nga 05.05.1998, nënshkroi Kartën Sociale Evropiane dhe është regjistruar nën CETS Nr. 163. Më 07.12.2004, Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar KSE së bashku me Protokollin, me të cilin plotësohet KSE nga viti 1991, dhe të njëjtat kanë hyrë në fuqi më 31.03.2005. Tekstin e rishikuar të Kartës Sociale Evropiane të regjistruar nën CETS Nr.163, Maqedonia e ka nënshkruar më 25.07.2009, e ka ratifikuar më 06.01.2012, dhe i njëjti ka hyrë në fuqi më 01.03.2012.

Protokolli shtesë i Konventës mbi krimin kibernetik, lidhur me kriminalizimin e karakterit racist dhe ksenofobik, nëpërmjet një sistemi kompjuterik, u nënshkrua më 14 nëntor 2005.

Instrumentet ndërkombëtare të cilët ende nuk janë të ratifikuar nga ana e R. së Maqedonisë, janë:

1. **Konventa Evropiane mbi Statusin Ligjor të Punëtorëve Sezonal** të 14.11.1977, e regjistruar nën CETS Nr.093, aktualisht nuk është as e nënshkruar e as e ratifikuar nga Republika e Maqedonisë dhe mund të shihet në linkun e mëposhtëm të Këshillit të Evropës.¹⁹

2. **Konventa për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal** të datës 05.02.1992 e regjistruar më 05.02.1992 nën CETS Nr. 144, aktualisht nuk është as nënshkruar e as e ratifikuar nga Republika e Maqedonisë. Mund të shihet në linkun e mëposhtëm të Këshillit të Evropës.²⁰

3. **Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Sezonal** nga data 18.12.1990, aktualisht as e nënshkruar dhe as e ratifikuar nga Republika e Maqedonisë. Mund të shihet në faqen e Kombeve të Bashkuara (OKB) në linkun e mëposhtëm.²¹

4. **Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve** e datës 11.05.1992, e regjistruar nën CETS Nr. 14.8, u nënshkrua më

¹⁹ [http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT= 163&CM=&DF=&CL=ENG](http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=163&CM=&DF=&CL=ENG)

²⁰ Ibid

²¹ <https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg no=IV13&chapter=4&lang=en>

25.07.1996, dhe e njëjta nuk është ratifikuar nga Republika e Maqedonisë.²²

Duke i pasur parasysh raportet e Komisionit Evropian dhe raportet e monitorimeve të ndryshme, është e pakontestueshme se autoritetet e Republikës së Maqedonisë duhet të ndjekin nga afër zbatimin e rregulloreve ligjore të miratuara në përputhje me Marrëveshjen kornizë të Ohrit, si dhe të ndjekin ndikimin e tyre në marrëdhëniet ndëretnike. Gjithashtu, duhet të ndërmerren iniciativa për të rritur ndërgjegjësimin, në mënyrë që të sigurohen segmente të ndryshme të publiku, që të kenë një kuptim të qartë të këtij legjislacioni të ri dhe zbatimin e tij. Çdo legjislacion modern kombëtar, synon për implementim të plotë dhe përputhshmëri të detyrimeve të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

PËRFUNDIMI

Për ti tejkaluar të gjitha keqkuptimet në lidhje me mosrespektimin e të drejtave të njeriut, duhet të sigurohen mekanizma për shfrytëzimin e plotë të nenit 9, në mënyrë që ai pa mëdyshje do të garanton parimin e barazisë para ligjit për të gjithë personat.

Shteti është ai që në radhë të parë duhet të sigurojë mekanizma me të cilat faktikisht do të zbatohen këto parime, gjegjësisht, që do ti sanksionojë situatat e tilla që gjenerojnë trajtim të ndryshëm.

Duhet të identifikohen arsyet pse në rastet e diskriminimit deri më tani askush me sukses nuk është thirrur në Nenin 9 të Kushtetutës dhe në Protokollin 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe ku është e nevojshme të ndërmerren masat e duhura për të hequr rëndësitë lidhur me thirrjen e këtyre dispozitave në procedurat gjyqësore dhe të sigurojë trajnim të posaçëm për përdorimin e tyre për avokatët dhe përfaqësuesit e gjyqësorit.

Duhet të merren një sërë masash në të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë penale, prokurorisë, policisë dhe gjyqësorit për të përmirësuar zbatimin e dispozitave të ligjit penal në lidhje me racizmin dhe diskriminimin. Gjithashtu duhet të ndërmerren masa edhe në kornizën institucionale për zbatimin e mbrojtjes nga diskriminimi, dhe duhet të merren iniciativa për të ngritur ndërgjegjësimin, me qëllim që të sigurohen

²² <http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=163&CM=&DF=&CL=ENG>

segmente të ndryshme te publikut që të ketë një kuptim të qartë të këtij legjislacioni dhe zbatimin e tij.

CONCLUSION

However, to overcome all these misunderstandings and disrespect for human rights, they must ensure mechanisms for full utilization of Article 9, so that it will unequivocally guarantee the principle of equality before the law for all persons.

The state in the first place should provide mechanisms by which de facto will apply these principles, namely, that would sanction such situations that generate different treatment.

They should identify the reasons why for discrimination cases so far no one successfully has not been called in Article 9 of the Constitution and 12 of the European Convention Protocol for Human Rights, and where it is necessary to take appropriate measures to remove essentials about the appeal of these provisions in court proceedings and to provide special training to use them for lawyers and representatives of the judiciary.

Must be taken a series of measures at all levels of the criminal justice system, prosecution, police and judiciary to improve the implementation of criminal law provisions relating to racism and discrimination. Also measures should be taken in the institutional framework for the implementation of protection from discrimination, It should be an initiative to establish order to ensure the various segments of the public to have a clear understanding of this legislation and its implementation.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Андреевска, Е. *Меѓународно јавно право*, Тетово, 2012
2. Андреевска, Е., *Политички Проблеми за Интегрирање Во ЕУ*, Тетово, 2012
3. Конвента Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut
4. Limani, M. *Integrime ekonomike Evropiane*, Prishtinë, 2008.
5. „*Разбирање на човековите права*“ (Doracak për edukimin nga lëmia e të drejtave të njeriut), Grac: Qendra Evropiane për trajnim dhe hulumtim të të drejtave të njeriut dhe demokraci – ETC, 2006
6. Reka, B., Ibrahim, A. *Studime Evropiane, Tetovë, 2004*

7. See European Council Decision on the drawing up a Charter of Fundamental Rights of the European Union, Annex IV of the Conclusions of the Presidency, Cologne European Council.

8. Sabine Bouet-Devriere., “*La protection universelle des droits de la femme: vers une efficacite accrue du droit positif international?* (Analyse prospective des dispositions du Protocole facultative a la Convention sur l’elimination de toutes les forms de discrimination a l’ egard des femmes)”, *Rew.trim. Dr. h.2000*.

9. <http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=163&CM=&DF=&CL=ENG>

10. https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TR EATY&mtmsg_no=IV13&chapter=4&lang=en